



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT**  
**AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT, FORMIMIT PROFESIONAL DHE**  
**KUALIFIKIMEVE**

**PROGRAM ORIENTUES PËR PROVIMIN PËRFUNDIMTAR**  
**KUALIFIKIMI PROFESIONAL “PUNIME DHE RIPARIM**  
**RRUGËSH”**

**(Niveli III në KSHK<sup>1</sup>, referuar Niveli III në KEK<sup>2</sup>)**

**Kodi: B4-III-23**

**Tiranë, 2024**

---

<sup>1</sup> Korniza Shqiptare e Kualifikimeve

<sup>2</sup> Korniza Evropiane e Kualifikimeve

**Programi orientues** për provimet përfundimtare të kualifikimit profesional “**Punime dhe riparim rrugësh**”, **Niveli III në KSHK, referuar Niveli III në KEK**, përmban temat dhe kompetencat më të rëndësishme dhe më përfaqësuese për këtë kualifikim profesional, të trajtuara në lëndët profesionale dhe në modulet e detyruara të praktikës profesionale në klasën e këtij niveli (klasa e 12-të), të cilat do të shërbejnë si bazë për të konceptuar provimet teorike dhe praktike përkatëse.

Ky program i ndihmon individët të përqendrohen në ato njohuri (koncepte, parime, ligjësi, procedura etj.) dhe kompetenca profesionale, që qëndrojnë në themel të profesionit për këtë nivel kualifikimi. Programi ndihmon, gjithashtu, edhe mësimdhënësit për organizimin e punës në përgatitjen për kontrollin përfundimtar të arritjeve të individëve.

Për drejtuesit e shkollave profesionale, këto programe krijojnë mundësinë për planifikimin dhe realizimin e Provimeve Përfundimtare në nivel shkolle.

Gjatë punës me këto programe kujdes duhet t’i kushtohet përvetësimit të njohurive dhe kompetencave themelore për këtë nivel kualifikimi, të cilat bëjnë të mundur integrimin e individit në botën e punës, por edhe që krijojnë vazhdimësinë e shkollimit të tij/saj në nivelin tjetër.

Gjatë përgatitjes së nxënësve për provimet përfundimtare të niveleve, është e rëndësishme që paraprakisht mësimdhënësit të zhvillojnë teste të individëve, me teste teorike apo praktike, të cilat mund t’i hartojnë vetë, duke përdorur instrumente vlerësimi në përputhje me kërkesat e këtij dokumenti. Gjatë hartimit të përmbajtjes së tyre duhen mbajtur parasysh njohuritë dhe kompetencat e përfshira në këtë program, kriteret e vlerësimit të përcaktuara në modulet përkatëse si edhe udhëzimet për vlerësimin e individëve.

Programi orientues përbëhet nga dy pjesë:

- programi orientues për provimin e teorisë profesionale të integruar;
- programi orientues për provimin e praktikës profesionale të integruar.

#### **A) Programi orientues për Provimin e Teorisë Profesionale të integruar**

**Programi orientues** për provimin e teorisë profesionale të integruar, në profilin mësimor “**Punime dhe riparim rrugësh**”, **Niveli III në KSHK, referuar Niveli III në KEK**, është hartuar duke u mbështetur në temat më të rëndësishme të programeve të lëndëve profesionale më përfaqësuese dhe më thelbësore, të cilat përbejnë 35 % të vëllimit të përgjithshëm të lëndëve profesionale, që përmban Skeletkurrikuli përkatës.

Lëndët profesionale të përfshira në programin orientues dhe peshat e tyre përkatëse janë:

#### **Tabela 1: Lëndët dhe peshat përkatëse në programin orientues**

Nr.	Lënda	Vëllimi i orëve për çdo lëndë	Peshat në %
1	Teknologjia e punimit, mirëmbajtjes dhe riparimit të rrugëve	64	78
2	Teknologji konstruksionesh mbajtëse në rrugë dhe vepra arti	18	22
	<b>TOTALI</b>	<b>82</b>	<b>100%</b>

**Temat sipas lëndëve janë:**

a) Temat nga lënda “**Teknologjia e punimit, mirëmbajtjes dhe riparimit të rrugëve**”, kl.12-të:

**Gjithsej 64 orë**

Tema 4	Teknologjia e punimeve për ndërtimin e rrugës	10 orë
Tema 5	Teknologjia e punimeve të gërmimit në rrugë	8 orë
Tema 6	Teknologjia e punimeve në veprat e artit, tombinot, pusetat dhe kanalet	10 orë
Tema 8	Teknologjia e punimeve të shtresave në trupin e rrugës	12 orë
Tema 9	Teknologjia e punimeve të trotuareve në rrugë	8 orë
Tema 10	Teknologjia e punimeve në mirëmbajtje dhe riparime rrugësh	8 orë
Tema 12	Teknologjia e punimeve në rrjetin inxhinierik në rrugë	8 orë

b) Temat nga lënda “**Teknologji konstruksionesh mbajtëse në rrugë dhe vepra arti**”, kl.12-të:

**Gjithsej 18 orë**

Tema 1	Konstruksionet mbajtëse dhe elementet konstruktive mbajtëse prej betoni të armuar në rrugë dhe vepra arti	8 orë
Tema 2	Parimet bazë për konstruktimin e elementeve mbajtëse prej betoni të armuar në rrugë dhe vepra arti	10 orë

**Udhëzime për përgatitjen e testit të provimit të teorisë profesionale:**

Provimi i teorisë profesionale të integruar do të jetë me test me shkrim, që zgjat 1.5 (një presje pesë) orë dhe përgatitet nga Komisioni i Vlerësimit të Provimit Përfundimtar të profilit të nivelit përkatës. Për hartimin e testit komisioni mund të mbështetet edhe tek banka e testeve të përgatitura nga AKAFPK-ja. Në hartimin e testit komisioni duhet të mbajë parasysh rregullat, parimet dhe formatet, për ndërtimin e testit.

Testi duhet të përmbajë 30 njësi testi me një total prej 60 pikë. Nga këto, 20 njësi testi të jenë me zgjedhje të shumëfishtë (4 alternativa) dhe 10 të tjerat të jenë njësi testi me përgjigje të

kufizuara/të mbyllura (me PO/JO; me e Vërtetë e Gabuar; me plotësim të fjalës që mungon; etj.)  
 Testi duhet të shmang pyetjet e hapura.  
 Njësitë e testit duhet të jenë të niveleve të ndryshme të vështirësisë, duke ndjekur skemën me tri nivele, si më poshtë:

### Model i shpërndarjes së pikëve për pyetje të niveleve të ndryshme në test

Niveli I (i ulët)	Niveli II (mesatar)	Niveli III (i lartë)
Aftësia për të rikujtuar/kuptuar/identifikuar dhe për të përshkruar...	Aftësia për të zbatuar/argumentuar/shpjeguar/krahasuar dhe për të analizuar...	Aftësia për të vlerësuar dhe për të nxjerrë përfundime...

### Ndarja e pikëve sipas peshës së çdo lënde dhe niveleve

Nr.	Lënda	Peshat e lëndëve në %	Pikët për çdo lëndë	Ndarja e pikëve sipas niveleve të vështirësisë		
				Niveli I 40% e pikëve	Niveli II 40% e pikëve	Niveli III 20% e pikëve
1	Teknologjia e punimit, mirëmbajtjes dhe riparimit të rrugëve	78	46	18	18	10
2	Teknologji konstruksionesh mbajtëse në rrugë dhe vepra arti	22	14	6	6	2
<b>TOTALI</b>		<b>100%</b>	<b>60 pikë</b>	<b>24 pikë</b>	<b>24 pikë</b>	<b>12 pikë</b>

Përcaktimi i pikëve për çdo njësi testi bëhet duke pasur parasysh tipin e njësisë së testit. Për shembull: njësitë e testit me zgjedhje të shumëfishtë marrin gjithmonë 1 (një) pikë përkundërt përgjigjes së paracaktuar të saktë; njësitë me përgjigje të hapur marrin aq pikë sa kërkesa kanë brenda tyre (duke mbajtur parasysh edhe argumentimin nga nxënësi); njësitë me përgjigje të kufizuara marrin aq pikë sa gjykohet nga grupi hartues dhe kjo lidhet me kërkesat që parashtrihen në pyetje dhe niveli i vështirësisë.

Së fundi, skema e vendosjes së notës kundërt pikëve të fituara përcaktohet nga grupi hartues i testit. Në vijim, jepet një model i skemës së vlerësimit me nota:

Pikët e fituara	Notat
<b>0 - 14</b>	<b>4</b>
<b>15 - 21</b>	<b>5</b>
<b>22 - 29</b>	<b>6</b>
<b>30 - 36</b>	<b>7</b>

37 - 43	8
44 - 52	9
53 - 60	10

## B) Programi orientues për Provimin e Praktikës Profesionale të integruar

**Programi orientues** për provimin e praktikës profesionale të integruar, në profilin mësimor “**Punime dhe riparim rrugësh**”, **Niveli III në KSHK, referuar Niveli III në KEK**, është hartuar duke u mbështetur në listën e kompetencave profesionale dhe në modulet e detyruara të praktikës profesionale, që përmban Skeletkurrikuli përkatës.

**Lista e kompetencave profesionale** për të cilat duhet të vlerësohen nxënësit, **detyrat e punës** dhe **pikët** për secilën kompetencë:

Nr	Kompetencat profesionale	Detyrat e punës	Pikët
1.	Të kryejë procese parapërgatitore.	1. Realizimi i një ose më shumë hapave si: të vendosë tabelat sinjalizuese për punime në rrugë; të interpretojë fletët e projektit, skicat, detajet e ndryshme për punime dhe riparim rrugësh, të kryejë llogaritje të volumeve dhe materialeve sipas proceseve të punës që do kryhet; të përzgjedhë veglat, makineritë, instrumentet e mjetet sipas procesit të punës, të përcaktojë radhën e kryerjes së punimeve, të përzgjedhë bazën materiale sipas procesit të punës, të kontrollojë dhe sigurojë gjendjen teknike të mjeteve, veglave dhe instrumenteve të punës; të pastrojë e sistemojë paraprakisht vendin e punës.	5
2.	Të kryejë punime piktetimi, modinimi, gjermimi dhe mbushje në rrugë.	2. Realizimi i një prej proceseve si: të kryejë piktetimin e aksit të rrugës nëpërmjet hedhjes në terren të pikave të rrugës sipas llojit; të kryejë modinimin e rrugës në sipërfaqe të pjerrët, në mbushje të lartë, me dhe pa bankinë sipas llojeve të rrugëve; të kryejë punimet e dheut në gjermim me krahë sipas modinimit të bërë; të kryejë punimet e dheut ndihmëse sipas modinimit të bërë pas gjermimit me makineri; të kryejë punimet e dheut në gjermim në sipërfaqe të rrafshët sipas modinimit të bërë, duke respektuar kushtet teknike; të kryejë punimet e dheut në gjermim në shpat mali për muret mbrojtëse, sipas modinimit të bërë, duke respektuar kushtet teknike; të kryejë	30

		punimet e dheut me shtresa homogjene e jo homogjene sipas modinimit të bërë dhe projektit të rrugës.	
<b>3.</b>	Të kryejë punime të shtresave në trupin e rrugës.	<b>3.</b> Realizimi i një prej proceseve si: të ngjeshë sipërfaqen e rrugës mbas gërmimeve të realizuara; të hedhë shtresën e parë me zhavorr të trashë/çakëll sipas kushteve teknike; të ndjekë lagjen me ujë të shtresave inerte me makineri; të kryejë në bashkëpunim me manovratorin cilindrimin e shtresës së parë me zhavorr të trashë/çakëll sipas kushteve teknike me makineri; të hedhë shtresën e dytë (të sipërme) me zhavorr të imët/çakëll sipas kushteve teknike; të kryejë cilindrimin e shtresës së dytë në bashkëpunim me manovratorin (të sipërme) me zhavorr të imët/çakëll sipas kushteve teknike me makineri; të largojë materialet e tepërta dhe të panevojshme që dalin gjatë punës; të pastrojë sipërfaqen dhe ta spërkasë atë me bitum të lëngshëm me mjetet dhe mekanizmat përkatëse sipas kushteve teknike duke bashkëpunuar me manovratorin; të shpërndajë çakëllin e imët 35-25 mm, ta cilindrojë atë dhe ta spërkasë me bitum të nxehtë me mjetet dhe mekanizmat përkatëse sipas kushteve teknike duke bashkëpunuar me manovratorin; të shpërndajë granilin e trashë 25-15 mm dhe atë të imët 15-5 mm dhe ta cilindrojë shtresën me mjetet dhe mekanizmat përkatëse sipas kushteve teknike duke bashkëpunuar me manovratorin; të shtrojë shtresën e binderit me mekanizëm sipas kushteve teknike; të kryejë cilindrimin e shtresës së binderit me mjetin ngjeshës (cilindrues) sipas kushteve teknike.	30
<b>4.</b>	Të kryejë punime ndërtimi të veprave të artit në rrugë.	<b>4.</b> Realizimi i një prej proceseve si: të hap themelin e tombinos dhe pusëtës dhe t'i jap pjerrësinë tabanit sipas projektit dhe kushteve teknike; të ndërtojë shtresën mbi të cilën do të vendosen elementet e tombinos dhe pusëtës, sipas projektit dhe kushteve teknike; të vendosë tubat dhe t'i lidhë ata me llaç çimento, sipas projektit dhe kushteve teknike; të hapë themelet e portaleve në hyrje dhe dalje të tombinos dhe pusëtës, sipas projektit dhe kushteve teknike; të ndërtojë muret e portaleve në	

		hyrje dhe dalje të tombinos dhe pusetës, sipas projektit dhe kushteve teknike; të ndërtojë shtresën veshëse të kanalit në hyrje dhe dalje të tombinos dhe pusetës, sipas projektit; të kryejë hidroizolim mbi tubat, sipas projektit dhe kushteve teknike; të kryejë mbushjen me dhe mbi tubat dhe ngjeshjen e dheut; të kryejë nivelimin e shtresës sipas kushteve teknike; të hedhë dhe ngjeshë shtresën e zhavorrit dhe betonit.	15
5.	Të kryejë punime riparimi dhe mirëmbajtjes së rrugëve	5. Realizimi i një prej proceseve si: të heqë shtresën e asfalt-betonit të dëmtuar me mjete dore ose të mekanizuara; të hap gropën në formë kuadrati dhe ta nivelojë fundin e saj sipas kushteve teknike; të pastrojë shtresat ekzistuese të rrugës me mjete dore ose të mekanizuara; të vendos shtresat e rrugës në vëllimin e krijuar të gropës, sipas renditjes ekzistuese dhe kushteve teknike; të shtrojë shtresën e binderit dhe ta cilindrojë atë sipas kushteve teknike; të shtrojë shtresën e asfalt-betonit dhe ta cilindrojë atë.	20
<b>Shuma</b>			<b>100</b>

**Skema e vlerësimit me nota:**

<b>Pikët e fituara</b>	<b>Notat</b>
<b>0 – 40</b>	<b>4</b>
<b>41 – 50</b>	<b>5</b>
<b>51 – 60</b>	<b>6</b>
<b>61 – 70</b>	<b>7</b>
<b>71 – 80</b>	<b>8</b>
<b>81 – 90</b>	<b>9</b>
<b>91 – 100</b>	<b>10</b>

**Shënime:**

- Provimi praktik do të realizohet me anë të metodës së vlerësimit të nxënësve për “*detyrat e punës*” në grupe pune ose individuale në mjediset e hapura të shkollës, kompani ndërtimi etj.
- Koha për realizimin e të gjitha detyrave duhet të jetë jo më shumë se 3 orë, në përputhje kjo me Udhëzimin për organizimin dhe zhvillimin e provimeve në AFP.
- Në çdo detyrë është shumë e domosdoshme **të përfshihen në vlerësim respektimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.**

- Në vlerësimin e kompetencave profesionale, rekomandohet t'i lihet hapësirë për vlerësim dhe bashkëbisedimit profesional ndërmjet anëtarëve të komisionit dhe nxënësit, pasi ai është element i rëndësishëm i secilës prej kompetencave të listuara. Komisioni i vlerësimit duhet të hartojë paraprakisht pyetjet për bashkëbisedimin profesional.
- Nxënësit duhet të punojnë në mënyrë të pavarur, pa ndërhyrjen e komisionit, me përjashtim të postit të punës, ku shkalla e rrezikshmërisë është relativisht e lartë.
- Për çdo detyrë, komisioni i vlerësimit duhet të përgatisë instrumentet përkatëse të vlerësimit sipas kompetencave profesionale. Instrumenti i vlerësimit për secilën detyrë duhet të përfshijë të gjitha hapat e realizimit të saj, duke filluar nga përgatitja materialeve e vendit dhe mjeteve të punës, pastrimin e vendit dhe mjeteve të punës, etj.
- Instrumenti i vlerësimit duhet të përfshijë në përmbajtjen e tij edhe kritere për vlerësimin e kompetencave kyçe profesionale si vetëkontrolli, përgjegjshmëria, manifestimi i guximit, angazhimi fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme. Gjithashtu, komisioni duhet të hartojë dhe një listë kriteresh vlerësimi për produktin përfundimtar.
- Për çdo detyrë komisioni duhet të përgatisë udhëzuesin e përmbushjes për nxënësit, ku do të jepen hapat për realizimin e detyrës përkatëse.

Përmbushja e kompetencës **“Të kryejë procese parapërgatitore “do të realizohet me Detyrën 1** në terren të hapur ose kompani ndërtimi.

Për realizimin e kësaj detyre, nxënësve duhet t'u sigurohen mjediset e punës, dokumentacioni teknik: tabelat sinjalizuese, urdhër pune, akte kontrolli, projekt zbatimi, detaje, skica, udhëzues dhe manuale përdorimi, udhëzues për zbatimin e rregullave sigurimit teknik e ruajtjen e mjedisit, pankarta me skica, detaje për punime piketimi, modinimi gjurmimeve e mbushjes në trasenë e rrugës, pajisje kancelarie, makina llogaritëse. Profili gjatësor e profilet tërthore të rrugës, udhëzues, pajimet, instrumentet matës/nivelues, makineri gjurmimi, transportues dherash, lopata, kazma, bel, shat, karroca, çekiç, spango etj.

Nxënësit në grupe ose në mënyrë individuale duke u angazhuar në mënyrë konkrete për një ose më shumë hapa si: të vendosin tabelat sinjalizuese për punime në rrugë; të interpretojnë fletët e projektit, skicat, detajet e ndryshme për punime e riparime rrugësh, të kryejnë llogaritje të volumeve dhe materialeve sipas proceseve të punës që do realizohet; të përzgjedhin veglat, makineritë, instrumentet e mjetet sipas procesit të punës, të përcaktojnë radhën e kryerjes së punimeve, të përzgjedhin bazën materiale sipas procesit të punës, të kontrollojnë dhe sigurojnë gjendjen teknike të mjeteve, veglave dhe instrumenteve të punës; të pastrojnë e sistemojnë paraprakisht vendin e punës; të sigurojnë ndriçimin e duhur dhe furnizimin me ujë.

Gjatë vlerësimit të nxënësve, komisioni i vlerësimit duhet të verifikojë shkallën e arritjeve të shprehive praktike si: vendosja e tabelave sinjalizuese për punime në rrugë; interpretimi i fletëve të projektit, skicave, detajeve të ndryshme për punime e riparim rrugësh, llogaritja e volumeve dhe materialeve sipas proceseve të punës që do kryhet; përzgjedhja e veglave, makinerive, instrumenteve e mjeteve sipas procesit të punës, përcaktimi i radhës së kryerjes së punimeve, përzgjedhja e bazës materiale sipas procesit të punës, kontrolli dhe sigurimi i gjendjes teknike të mjeteve, veglave dhe instrumenteve të punës; pastrimi e sistemimi paraprak i vendit të punës; sigurimi i ndriçimit të duhur dhe furnizimit me ujë.



Nxënësit në grupe ose në mënyrë individuale, vlerësohen me listë kontrolli e cila hartohet nga komisioni i provimit dhe duhet të përmbajë të gjitha hapat e procedurës së realizimit të kësaj detyre si: pyetje - përgjigje me gojë, vëzhgim me listë kontrolli etj. Kjo listë kontrolli mund të përmbajë edhe kritere për vlerësimin e kompetencave kyçe profesionale. Gjatë hartimit të listës së kontrollit të përfshihen dhe kompetencat kyçe, të tilla si angazhimi për realizimin e detyrës, pavarësia, kreativiteti, vetëkontrolli etj.

Përmbushja e kompetencës **“Të kryejë punime piketimi, modinimi, gjurmimi dhe mbushje në rrugë”** do të realizohet me **Detyrën 2** në terren të hapur ose kompani ndërtimi.

Për realizimin e kësaj detyre, nxënësve duhet t’u sigurohen mjediset, dokumentacioni teknik, urdhër pune, akte kontrolli, projekt zbatimi, detaje, skica, udhëzues dhe manuale përdorimi, udhëzues për zbatimin e rregullave sigurimit teknik e ruajtjen e mjedisit, pankarta me skica, detaje për punime piketimi, modinimi, gjurmimeve e mbushjes në trasenë e rrugës, instrumentet matëse e nivelues, teodolit, nivelë, kompleti i veshjes së punës, gozhdë, përforcues, modina, kunja piketimi, shënues, çekiç, pajisje kancelarie, makina llogaritëse, profili gjatësor e profilet tërthore të rrugës dhe tabela e dherave, manualet e preventivimit dhe të zbrërthimin e kostos.

Nxënësit në grupe ose në mënyrë individuale duke u angazhuar në mënyrë konkrete në një ose më shumë hapa si: të kryejnë piketimin e aksit të rrugës nëpërmjet hedhjes në terren të pikave të rrugës sipas llojit; të kryejnë modinimin e rrugës në sipërfaqe të pjerrët, në mbushje të lartë, me dhe pa bankinë sipas llojeve të rrugëve; të kryejnë punimet e dheut në gjurmim me krahë sipas modinimit të bërë; të kryejnë punimet e dheut ndihmëse sipas modinimit të bërë pas gjurmimit me makineri; të kryejnë punimet e dheut në gjurmim në sipërfaqe të rrafshët sipas modinimit të bërë, duke respektuar kushtet teknike; të kryejnë punimet e dheut në gjurmim në shpat mali për muret mbrojtëse, sipas modinimit të bërë, duke respektuar kushtet teknike; të kryejnë punimet e dheut me shtresa homogjene e jo homogjene sipas modinimit të bërë dhe projektit të rrugës.

Gjatë vlerësimit të nxënësve, komisioni i vlerësimit duhet të verifikojë shkallën e arritjeve të shprehive praktike si: kryerja e piketimit të aksit të rrugës nëpërmjet hedhjes në terren të pikave të rrugës sipas llojit; kryerja e modinimit të rrugës në sipërfaqe të pjerrët në mbushje të lartë, me dhe pa bankinë sipas llojeve të rrugëve; kryerja e punimeve të dheut në gjurmim me krahë sipas modinimit të bërë; kryerja e punimeve e dheut ndihmëse sipas modinimit të bërë pas gjurmimit me makineri; kryerja e punimeve të dheut në gjurmim në sipërfaqe të rrafshët sipas modinimit të bërë, duke respektuar kushtet teknike; kryerja e punimeve të dheut në gjurmim në shpat mali për muret mbrojtëse, sipas modinimit të bërë, duke respektuar kushtet teknike; kryerja e punimeve të dheut me shtresa homogjene e jo homogjene sipas modinimit të bërë dhe projektit të rrugës.

Nxënësit në grupe ose në mënyrë individuale, vlerësohen me listë kontrolli e cila hartohet nga komisioni i provimit dhe duhet të përmbajë të gjitha hapat e procedurës së realizimit të kësaj detyre si: pyetje - përgjigje me gojë, vëzhgim me listë kontrolli etj. Kjo listë kontrolli mund të përmbajë edhe kritere për vlerësimin e kompetencave kyçe profesionale. Gjatë hartimit të listës së kontrollit të përfshihen dhe kompetencat kyçe, të tilla si angazhimi për realizimin e detyrës, pavarësia, kreativiteti, vetëkontrolli etj.

Përmbushja e kompetencës **“Të kryejë punime të shtresave në trupin e rrugës”** do të realizohet me **Detyrën 3** në terren të hapur ose kompani ndërtimi.

Për realizimin e kësaj detyre, nxënësve duhet t'u sigurohen mjediset e punës, dokumentacioni teknik: urdhër pune, akte kontrolli, projekt zbatimi, detaje, skica, udhëzues dhe manuale përdorimi, udhëzues për zbatimin e rregullave sigurimit teknik e ruajtjen e mjedisit pankarta me skica, detaje për kryerjen e punimeve në trupin e rrugës; mjetet, instrumentet matëse e niveluese, instrumentet gjeodezike; makineri asfaltimi, transportues inertesh, uji dherash, lopata, kazma, karroca; kompleti i veshjes së punës; materialet për punimet e kryerjes së punimeve në trupin e rrugës; inerte zhavorr/çakëll me granulometri të ndryshme, dhera të përpunuara, bitum, asfaltobeton, ujë, pajisje kancelarie, makina llogaritëse, profili gjatësor e profilet tërthore të rrugës.

Nxënësit në grupe ose në mënyrë individuale duke u angazhuar në mënyrë konkrete në një ose më shumë hapa si: të kryejnë ngjeshjen e sipërfaqes së rrugës mbas gërmimeve të realizuara; të hedhin shtresën e parë me zhavorr të trashë/çakëll sipas kushteve teknike; të ndjekin lagjen me ujë të shtresave inerte me makineri; të kryejnë në bashkëpunim me manovratorin cilindrimin e shtresës së parë me zhavorr të trashë/çakëll sipas kushteve teknike me makineri; të hedhin shtresën e dytë (të sipërme) me zhavorr të imët / çakëll sipas kushteve teknike; të kryejnë cilindrimin e shtresës së dytë në bashkëpunim me manovratorin (të sipërme) me zhavorr të imët/çakëll sipas kushteve teknike me makineri; të largojnë materialet e tepërta dhe të panevojshme që dalin gjatë punës; të pastrojnë sipërfaqen dhe ta spërkatën atë me bitum të lëngshëm me mjetet dhe mekanizmat përkatëse sipas kushteve teknike duke bashkëpunuar me manovratorin; të shpërndajnë çakëllin e imët 35-25 mm, ta cilindrojnë atë dhe ta spërkatën me bitum të nxehtë me mjetet dhe mekanizmat përkatëse sipas kushteve teknike duke bashkëpunuar me manovratorin; të shpërndajnë granilin e trashë 25-15 mm dhe atë të imët 15-5 mm dhe ta cilindrojnë shtresën me mjetet dhe mekanizmat përkatëse sipas kushteve teknike duke bashkëpunuar me manovratorin; të shtrojnë shtresën e binderit me mekanizëm sipas kushteve teknike; të kryejnë cilindrimin e shtresës së binderit me mjetin ngjeshës (cilindrues) sipas kushteve teknike.

Gjatë vlerësimit të nxënësve, komisioni i vlerësimit duhet të verifikojë shkallën e arritjeve të shprehive praktike si: kryerja e ngjeshjes së sipërfaqes së rrugës mbas gërmimeve të realizuara; hedhja e shtresës së parë të zhavorrit të trashë/çakëll sipas kushteve teknike; lagja me ujë të shtresave inerte me krahë/makineri; në bashkëpunim me manovratorin, cilindrimi me makineri i shtresës së parë me zhavorr të trashë/çakëll sipas kushteve teknike; hedhja e shtresës së dytë (të sipërme) me zhavorr të imët/çakëll sipas kushteve teknike; cilindrimi i shtresës së dytë (të sipërme) me zhavorr të imët/çakëll në bashkëpunim me manovratorin sipas kushteve teknike me makineri; largimi i materialeve të tepërta dhe të panevojshme që dalin gjatë punës; pastrimi i sipërfaqes dhe spërkatja saj me bitum të lëngshëm me mjetet dhe mekanizmat përkatëse sipas kushteve teknike duke bashkëpunuar me manovratorin; shpërndarja e çakëllit të imët 35-25 mm, cilindrimi tij dhe spërkatja me bitum të nxehtë me mjetet dhe mekanizmat përkatëse sipas kushteve teknike duke bashkëpunuar me manovratorin; shpërndarja e granilit të trashë 25-15 mm dhe të imët 15-5 mm dhe cilindrimi shtresës me mjetet dhe mekanizmat përkatëse sipas kushteve teknike duke bashkëpunuar me manovratorin; shtrimi i shtresës së binderit me mekanizëm sipas kushteve teknike; cilindrimi i shtresës së binderit me mjetin ngjeshës (cilindrues) sipas kushteve teknike.

Nxënësit në grupe ose në mënyrë individuale, vlerësohen me listë kontrolli e cila hartohet nga komisioni i provimit dhe duhet të përmbajë të gjitha hapat e procedurës së realizimit të kësaj detyre si: pyetje - përgjigje me gojë, vëzhgim me listë kontrolli etj. Kjo listë kontrolli mund të përmbajë edhe kritere për vlerësimin e kompetencave kyçe profesionale. Gjatë hartimit të listës së kontrollit të përfshihen dhe kompetencat kyçe, të tilla si angazhimi për realizimin e detyrës, pavarësia, kreativiteti, vetëkontrolli etj.

Përmbushja e kompetencës **“Të kryejë punime ndërtimi të veprave të artit në rrugë”** do të realizohet me **Detyrën 4** në terren të hapur ose kompani ndërtimi.

Për realizimin e kësaj detyre, nxënësve duhet t’u sigurohen mjediset e punës, pankarta me skica, detaje për kryerjen e ndërtimit të veprave të artit në rrugë; mjetet, instrumentet matëse e niveluese, instrumentet gjeodezike; makineri transportues inertesh, uji dherash, lopata, kazma, karroca; kompleti i veshjes së punës; materialet për punimet e kryerjes së ndërtimit të veprave të artit në rrugë; inerte, dhera të përpunuara, ujë, tuba, gurë natyror; pajisje kancelarie, makina llogaritëse; profili gjatësor e profilet tërthore të rrugës etj.

Nxënësit në grupe ose në mënyrë individuale duke u angazhuar në mënyrë konkrete në një ose më shumë hapa si: të hapin themelin e tombinos dhe pusëtës dhe t’i japin pjerrësinë tabanit sipas projektit dhe kushteve teknike; të ndërtojnë shtresën mbi të cilën do të vendosen elementet e tombinos dhe pusëtës, sipas projektit dhe kushteve teknike; të vendosin tubat dhe t’i lidhin ata me llaç çimento, sipas projektit dhe kushteve teknike; të hapin themelet e portaleve në hyrje dhe dalje të tombinos dhe pusëtës, sipas projektit dhe kushteve teknike; të ndërtojnë muret e portaleve në hyrje dhe dalje të tombinos dhe pusëtës, sipas projektit dhe kushteve teknike; të ndërtojnë shtresën veshëse të kanalit në hyrje dhe dalje të tombinos dhe pusëtës, sipas projektit; të kryejnë hidroizolimimin mbi tubat, sipas projektit dhe kushteve teknike; të kryejnë mbushjen me dhë mbi tubat dhe ngjeshjen e dheut; të kryejnë nivelimin e shtresës sipas kushteve teknike; të hedhin dhe ngjeshin shtresën e zhavorrit dhe betonit.

Gjatë vlerësimit të nxënësve, komisioni i vlerësimit duhet të verifikojë shkallën e arritjeve të shprehive praktike si: hapja themelit, tombinos dhe pusëtës dhe dhënia e pjerrësisë së tabanit sipas projektit dhe kushteve teknike; ndërtimi shtresës mbi të cilën do të vendosen elementet e tombinos dhe pusëtës, sipas projektit; vendosja e tubave dhe lidhja e tyre me llaç çimento, sipas detajit projektit; hapja themelit e portaleve në hyrje dhe dalje të tombinos dhe pusëtës, sipas projektit; ndërtimi i mureve e portaleve në hyrje dhe dalje të tombinos dhe pusëtës, sipas projektit; ndërtimi shtresës veshëse të kanalit në hyrje dhe dalje të tombinos dhe pusëtës, sipas projektit; hidroizolimi mbi tubat, sipas projektit dhe kushteve teknike; mbushja me dhe mbi tubat dhe ngjeshja e dheut, sipas projektit dhe kushteve teknike; nivelimi i shtresës sipas kushteve teknike; hedhja dhe ngjeshja e shtresës zhavorrit dhe betonit, sipas projektit dhe kushteve teknike;

Nxënësit në grupe ose në mënyrë individuale, vlerësohen me listë kontrolli e cila hartohet nga komisioni i provimit dhe duhet të përmbajë të gjitha hapat e procedurës së realizimit të kësaj detyre si: pyetje - përgjigje me gojë, vëzhgim me listë kontrolli etj. Kjo listë kontrolli mund të përmbajë edhe kritere për vlerësimin e kompetencave kyçe profesionale. Gjatë hartimit të listës së kontrollit të përfshihen dhe kompetencat kyçe, të tilla si angazhimi për realizimin e detyrës, pavarësia, kreativiteti, vetëkontrolli etj.

Përmbushja e kompetencës “**Të kryejë punime të riparimit dhe mirëmbajtjes së rrugëve**” do të realizohet me **Detyrën 5** në terren të hapur ose kompani ndërtimi.

Për realizimin e kësaj detyre, nxënësve duhet t’u sigurohen mjediset e punës, pankarta me skica, detaje për kryerjen e riparimit dhe mirëmbajtjes e rrugëve; mjetet, instrumentet matëse e niveluese, instrumentet gjeodezike; makineri transportues inertesh, uji dherash, lopata, kazma, karroca, kompleti i veshjes së punës; materialet për punimet e kryerjes së riparimit dhe mirëmbajtjes së rrugëve; inerte, bitum, asfaltobeton, dhera të përpunuara, ujë, tuba, gurë natyror, pajisje kancelarie, makina llogaritëse; profili gjatësor e profilet tërthore të rrugës.

Nxënësit në grupe ose në mënyrë individuale duke u angazhuar në mënyrë konkrete në një ose më shumë hapa si: të heqin shtresën e asfalt-betonit të dëmtuar me mjete dore ose të mekanizuara; të hapin gropën në formë kuadrati dhe ta nivelojnë fundin e saj sipas kushteve teknike; të pastrojnë shtresat ekzistuese të rrugës me mjete dore ose të mekanizuara; të vendosin shtresat e rrugës në vëllimin e krijuar të gropës, sipas renditjes ekzistuese dhe kushteve teknike; të shtrojnë shtresën e binderit dhe ta cilindrojnë atë sipas kushteve teknike; të shtrojnë shtresën e asfalt-betonit dhe ta cilindrojnë atë.

Gjatë vlerësimit të nxënësve, komisioni i vlerësimit duhet të verifikojë shkallën e arritjeve të shprehive praktike si: heqja e shtresës së asfalt-betonit të dëmtuar me mjete dore ose të mekanizuara; hapja gropës në formë kuadrati dhe nivelimi i fundit të saj sipas kushteve teknike; pastrimi shtresave ekzistuese të rrugës me mjete dore ose të mekanizuara; vendosja e shtresave të rrugës në vëllimin e krijuar të gropës, sipas renditjes ekzistuese dhe kushteve teknike; shtrimi shtresës binderit dhe cilindrimi tij sipas kushteve teknike; shtrimi shtresës asfalt-betonit dhe cilindrimi tij.

Nxënësit në grupe ose në mënyrë individuale, vlerësohen me listë kontrolli e cila hartohet nga komisioni i provimit dhe duhet të përmbajë të gjitha hapat e procedurës së realizimit të kësaj detyre si: pyetje - përgjigje me gojë, vëzhgim me listë kontrolli etj. Kjo listë kontrolli mund të përmbajë edhe kritere për vlerësimin e kompetencave kyçe profesionale. Gjatë hartimit të listës së kontrollit të përfshihen dhe kompetencat kyçe, të tilla si angazhimi për realizimin e detyrës, pavarësia, kreativiteti, vetëkontrolli etj.

Rekomandohet që secila nga detyrat e punës së lartpërmendur të ketë listë vlerësimi më vete dhe në fund të realizimit të detyrave të parashikuara në 5 (pesë) **Detyra** pune, të bëhet tabela përmbledhëse e pikëve dhe nota përkatëse.